

## Titulli i lëndës: TEORIA DHE KRITICIZMI NË ARKITEKTURË

Informatat themelore për lëndën	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Arkitekturës
<b>Titulli i lëndës:</b>	Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë
<b>Niveli:</b>	BA
<b>Statusi i lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	III
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+1
<b>Kreditë ECTS:</b>	4
<b>Koha / Vendi:</b>	Sipas orarit
<b>Mësimdhënësi:</b>	Prof.Asoc.Dr. Florina Jerliu, Ass. Denis Dalladaku, Ass. Endrit Mecini
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<a href="mailto:florina.jerliu@uni-pr.edu">florina.jerliu@uni-pr.edu</a> , <a href="mailto:Denis.dalladaku@uni-pr.edu">Denis.dalladaku@uni-pr.edu</a> , <a href="mailto:endrit.mecini@uni-pr.edu">endrit.mecini@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Lënda shtjellon nocionet themelore, përbërësit dhe parimet bazë të arkitekturës prej Vitruvit deri sot. Në këtë kuadër, studentët do të njihen me trajtesat teorike dhe kritike në lidhje me estetikën, pushtetin, evolucioni dialektik në arkitekturë, gjenezën e arkitekturës (Initium Topos), traditën dogmatike dhe thyerjen e saj, përkufizimet rreth stilit dhe shijes së lartë në arkitekturë, për të arritur te konceptet dhe konteksti i dilemave të arkitekturës në kohët recente të modernitetit dhe postmodernës
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Hulumtimi i ideve të cilat qëndrojnë prapa pamjes së ndërtesave, e që në fakt është teoria e arkitekturës; Të kuptuarit e polaritetit midis njohurive specialiste dhe vazhdimësisë së njohurive të njerëzimit; Teoria dhe praktika janë të pandara, prandaj synohet qasja kritike ndaj të krijuarit si rrjedhojë e konventave tradicionale, koncepteve eksperimentale dhe gjykimeve estetike, e që ndihmon në formësimin e gjykimit teorik dhe kritik të studentit të arkitekturës.
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të: <ul style="list-style-type: none"> <li>– aftësohet në interpretimin e bazës teorike të arkitekturës, traktateve dhe qëndrimeve kritike nga arkitektët dhe teoricienët e arkitekturës;</li> <li>– krijojë kuadrin e gjykimit kritik ndaj idesë, koncepteve themelore dhe prodhimit arkitektonik në kontekst,</li> <li>– zhvillojë shkathhtësi në artikulum, referencim teorik dhe shkrim akademik</li> </ul>

<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë mësimore</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
<b>Total</b>			<b>100</b>
<b>Metodat e mësimdhënies:</b>	Ligjërata interaktive, diskutimeve, detyrë shtëpie individuale dhe grupore, prezantime të punës së studentëve.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<i>(Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%.</i> Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%; Detyrat seminarike dhe prezantimet e studentëve 60%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 30%		
<b>Literatura primare:</b>	F.Jerliu (2005) Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë, UP/WUS, Dispencë Ch. Jencs , K.Kropf (2006)Theories and manifestoes of contemporary architecture, second edition, Academy Press Hanno-Walter Kruft (1996) History of Architectural Theory, from Vitruvius to the present , Princeton Architectural Press Vitruvius (1960) The Ten Books on Architecture, Dover Publications: Obligative kaptinat: a) Libri 2/K1, b) Libri 3/K1, c) Libri 4K1 Alberti (1991) On the art of building in Ten Books / De re aedificatoria/ - Obligative kaptinat: a) Libri 6/K4, b) Libri 9/K1 Marc-Antoine Laugier (W. H. and A. H., 2009). An essay on architecture - Obligative kaptina: K1 Mari Hvattum(2004) Gottfried Semper and the Problem of Historicism, Cambridge University Press (obligative: The Cult of Origins, ff 29-35) Revista e lëndës “ARKITEKTURA – Diskurs Teorik” numrat 1,2,3		
<b>Literatura shtesë:</b>	K. Michael Hays (Ed.) (200) Architecture Theory since 1968, The MIT Press Andrea Palladio, R.S. , R. T. Transl. (2002) The four books on architecture, The MIT Press Hilde Heynen (2000) Architecture and modernity, A Critique, The MIT Press; Revised edition		

Joseph Rykwert (1981) On Adam's House in Paradise, The MIT Press; 2nd edition

**Hartimi i planit mësimor**

<b>Java</b>	<b>Titulli i ligjëratës</b>	<b>Ushtrimet</b>
<i>Java 1:</i>	Hyjre në lëndë	Prezentimi i detyrës së parë dhe ndarja e teorive përkatëse (Teoria)
<i>Java 2:</i>	Estetika dhe Pushteti si bazat e teorisë së arkitekturës	Lexim dhe hulumtim mbi teoritë përkatëse
<i>Java 3:</i>	Vitruvi dhe Lashtësia: Parimet e arkitekturës	Diskutim mbi teoritë përkatëse
<i>Java 4:</i>	Teoria e renesansës. Natyra dhe Rregulli (Alberti, Filarete, Serlio, Vignola)	Elaborimi i teorisë së përcaktuar në bazë të të paktën 3 çështjeve kyçe/keywords të identifikuara në tekstin teorik
<i>Java 5:</i>	Fundi i Vitruvianizmit: Shija e Lartë në Arkitekturë	Formulimi i pyetjeve mbi fjalëve kyçe të identifikuara në tekstin teorik
<i>Java 6:</i>	Semper: Stili	Zhvillimi i pohimeve, të ndërtuara mbi pikëpamjet individuale rreth pyetjeve të formulara paraprakisht
<i>Java 7:</i>	Prezetime të punës të detyrës së parë	Prezetime të punës të detyrës së parë
<i>Java 8:</i>	Initium - Topos	Prezentimi i detyrës të dytë (Kritika)
<i>Java 9:</i>	Hyrje në arkitekturën moderne: Nociione dhe Baza (parimet)	Diskutim krahasues i teorive përkatëse
<i>Java 10:</i>	Dilemat e arkitekturës moderne. Genius Loci v. Pastrehësia	Elaborimi i çështjeve kyçe në raport me tekstin kritik
<i>Java 11:</i>	Hapësira: Hapësira dhe Transparenca arkitekturale 1	Analizë komparative: kritika si antitezë ose/dhe kontribut
<i>Java 12:</i>	Hapësira: Hapësira dhe Transparenca arkitekturale 2	Përpilimi dhe strukturimi i argumenteve të antitezës
<i>Java 13:</i>	Vendi. Vendet, Vendbanimet, Jo-Vendet (non-lieux)	Zhvillimi i mëtutjeshëm i detyrës
<i>Java 14:</i>	Prezetime të punës të detyrës së dytë	Prezetime të punës të detyrës së dytë
<i>Java 15:</i>	Rekapitullim i lëndës	Dorëzimi final i detyrës së dytë

### **Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

Ligjëratat janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet dhe vlerësohet bashkëbisedimi dhe interaksioni gjatë orës; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për shfletim të materies në diskutim, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale.

**Shënim | Nëse detyra seminarike e një studenti vlerësohet nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final**